

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIKË E KOSOVËS	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Nr. Prot. Br Prot Prot No	03-02/1010/16
Data Datum Date	08.03.2016
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 07.03.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-2793/15, për z. Branko Bojovic – Këshilltar Komunal në Komunën e Leposaviqit, për shkak se ai ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-2793/15, për z. Branko Bojovic – Këshilltar Komunal në Komunën e Leposaviqit, dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat “M&A-COM”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e AKK-së.

z. Bojovic është njoftuar se nuk mund të ushtroj në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë në biznesin privat, krahas funksionit publik të zyrtarit të lartë si dhe për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur konfliktin e interesit. Ai ka premtuar se do të shmang konfliktin e interesit duke caktuar një person të autorizuar për të administruar biznesin e tij.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se ka caktuar një person të autorizuar për të menaxhuar biznesin privat "M&A-COM". Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.


II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.


Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Uskladu sa članom 11.(stav1.1), članom 5(stav 1, tačka 1.5), članom 18(stav10 i 11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, kao i sa članom 24 (stav11 i 12) Pravilnika o Radu Agencije protiv Korupcije, Direktor Agencije protiv Korupcije, dana 07.03.2016 doneo je sledeću:

ODLUKU

- I. Zatvara se slučaj br. AKK – 03-02-2793/15, za g. Branko Bojovic – Opštinski odbornik u Opštini Leposavić, zato što je visoki javni zvaničnik izbegao Sukob Interesa u kojem se nalazio.**
- II. Slučaj se može obnoviti u svako doba ukoliko se pojavljuju nove okolnosti.**

O b r a z l o ž e n j e

I.Slučaj je otvoren pod osnovanom sumnjom o Sukobu Interesa u Toku Vršnja Javne Funkcije, za visokog zvaničnika, g.Branka Bojovića, Opštinskog Odbornika u Opštini Leposavić, istovremeno vlasnik u privatnom biznesu "M&A-COM", i tretiran je prema predviđenoj proceduri u Zakonu br.04/L-051 za Sprečavanje Sukoba Interesa u Toku Vršnja Javne Funkcije.

Visoki zvaničnik je prvo, službenim pismom upoznat od strane Agencije protiv Korupcije za početak procedure razmatranja slučaja stanja mogućeg sukoba interesa, nakon čega je on kontaktiran od strane zvaničnika APK.

g.Bojović je obavešten da ne može na aktivan način vršiti vlasničko pravo u privatnom biznesu, uporedo sa funkcijom visokog javnog zvaničnika kao i sa izmenama koje treba izvršiti da bi izbegao sukob interesa. On je obećao da će izbegnuti sukob interesa time što će ovlastiti jedno lice radi administriranja njegovim biznisom.

U međuvremenu , visoki zvaničnik g.Bojović je Agenciji dostavio službeno pismo izdato od Agencije za Registraciju Biznesa na Kosovu na kojem se potvrđuje da je ovlastio jedno lice radi menadžiranja privatnim biznisom "M&A-COM". Ovime je visoki zvaničnik izbegao situaciju sukoba interesa na kojem se nalazio.

S toga je odlučeno kao u dispozitivu ovog rešenja

II. U skladu sa članom 18 (stav11) Zakona br. 03/L-15 za Agenciju protiv Korupcije, Agencija može u svako doba ponovo otvoriti slučaj ukoliko sa jave nove okolnosti.

Rešenje se dostavlja: Hasan Preteni

- Visokom javnom zvaničniku
- Direktor DSK
- g./g-đi. (odgovornom službeniku)

Direktor Agencije protiv Korupcije

Hasan Preteni

